Asambleja
01.Nr.IV
Deçan,dt.28.04.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IV-të, të rregullt të Kuvendit, me dt.28.04.2023.
Në mbledhje ishin prezent:25 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale (8), OSBE(Have Lajçi).
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2027,
3. Rishqyrtim i vendimit të dt.28.02.2023 për bartje të hyrave vetanake nga viti paraprak 2022 në vitin aktual fiskal 2023,
4. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2023,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e IV-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 25 anëtarë të kuvendit (mungojnë: Hamid Zukaj dhe Sylë Balaj), e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë, pastaj i propozoj në pikën Të ndryshme, edhe dy pika të rendit të ditës të cilat janë propozuar pasi që është bërë rendi i punës, nën 1. Caktimi i lokacionit për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore, dhe 2. Shfuqizimi i Vendimit të Kuvendit i dt.25.03.2013, me të cilin është Aprovuar lista rezervë për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Deçanit, pastaj e hapi debatin rreth rendit të ditës.
Albesa Cacaj- thotë se në muajin prill kanë qenë planifikuar për rend pune, Plani i veprimit për energji dhe klimë, Raporti i NPL "Higjjiena" dhe Plani për barazi gjinore, dhe kërkoj sqarim pse nuk kanë dalë në rend dite këto tri dokumente.
Kryesuesi- ka thënë që dy Planet nuk kanë qenë të përgaditura ende kurse raporti i NPL "Higjiena" nuk ka ardhë për shqyrtim, sepse ende nuk ka ardhë raporti i Auditorit, e pastaj duhet të del në Kuvend kjo pikë.
Rendi i punës miratohet njëzëri me dy pikat e propozuara në të ndryshme - 1. Caktimi i lokacionit për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore, dhe 2. Shfuqizimi i Vendimit të Kuvendit i dt.25.03.2013, me të cilin është Aprovuar lista rezervë për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Deçanit.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Kryesuesi- e ka hapë debatin rreth procesverbalit.
Orges Tafilaj-në fq.2. pas fjalës së drejtoreshës kam thënë, unë e di që pasqyrat financiare i raportoni në Ministri të Financave, megjithatë ju falënderoj që ma konfirmuat fjalën time që ky është vetëm raport i shpenzimeve, po ashtu në mes të fq.2 te diskutimi im, fjalinë e parë e leni ashtu si është dhe vazhdoni "pagesat për shpenzimet për dreka, darka dhe karburante për vetura janë të mëdha, të dhimshme janë sidomos pagesat e kryera përmes përmbaruesve që e dëmton buxhetin, buxhet i cili ka mundë të përdoret për investime kapitale. fq.3. në fund të diskutimit të shtohet teksti" dhe kërkon të gjindet mënyra dhe mundësitë financiare të përkrahen", fq.4. plotësim teksti " a janë të paisura

qebaptoret dhe restorantet me certifikatë mbi cilësinë e mishit", te pjesa e ndotjes së ambientit nga ujërat e zeza i shtohet teksti" është problem të ndodhë për shkak të mundësisë dhe mungesës së investimeve kapitale dhe shfaqet në infrastrukturë qytetare duke filluar nga fshati im", në fq.5. në fund të diskutimit vazhdon fjalia me tekst" në mënyrë që kompania të operoj më mirë dhe të mbuloj borgjet.

Miftar Ahmetxhekaj- ka vërejtje, në fq.3. nuk i është përfshi drejtë diskutimi i tij te pika nr.3 e rendit të ditës-Shqyrtimi i raportit të Komitetit të Komuniteteve dhe po ashtu në fq.4 te Shqyrtimi i Model-rregullores për taksat komunale nuk i është përfshi diskutimi dhe propozimet për ndryshim plotësimet në tekstin e propozuar të model-rregullores, dhe përfundimisht ka thënë ai është mirë që të gjendet formë për përfshirjen e diskutimeve në procesverbal, si dhe ka shtuar se i kam dorëzuar disa kërkesa me shkrim për trajtim në këtë mbledhje, për të cilat ka thënë kryesuesi se do të debatohen në pikën Të ndryshme.

Njëzëri miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar, me plotësimet në vërejtjet e bëra ma lartë nga dy asamblistët.

II. Shqyrtimi i Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2027.

Yllarta Thaqi thotë se materiali i ofruar është kopy-paste e strategjisë së kaluar dhe ka nevojë për ndryshim komplet esencial sepse nuk përputhet as 70 % me gjendjen ekzistuese, duhet të bëhet revidim komplet i strategjisë së kaluar, në strategji shënohen disa gjana që nuk organizohen ma, siq është java e maturantëve, prandaj ka nevojë që të formohet një komision dhe mu hartu një strategji krejtësisht e re.

Miftar Ahmetxhekaj- thotë se ka qenë praktikë që sponzorizuesi fillimisht ka dhënë sqarime për temën e propozuar prandaj edhe sot ka qenë mirë fillimisht sponzorizuesi i kësaj Strategjie të ep sqarime rreth strategjisë së propozuar e pastaj ne si asamblist të japim mendimet tona.

Orges Tafilaj- fillimisht thotë se pajtohem me shumicën me ato që tha Yllarta, strategjia hartohet për 4 vitet e ardhshme dhe uroj që ajo të bëhet realitet, te fq.27 buxheti është paraparë për aktivitete si prioritete që pritet të realizohen, megjithate problemi kryesor është që brenda kësaj strategjie duhet të përfshihet transmetimi i seancave të kuvendit live- edhe nëse kemi tender në të ardhmen për media të caktuara realisht them se është e nevojshme që të bëhen njoftime të nevojshme që të bëhet transmetimi i seancave përmes faqes zyrtare të komunës dhe të gjitha këto duhet të përfshihen në strategji, si dhe te Ceremonitë e mirënjohjeve janë parapa 2000 euro, dhe kisha pasë dëshirë të di çka është paraparë këtu.

Mon Selmonaj-thotë se i bashkangjitem parafolësve në ato çka deklaruan para meje, si draft them se është strategji ambicioze, dhe të miratohet me disa plotësime, mirëpo raporti i zyrës për informim nuk është bash i kënaqshëm dhe në nivelin e duhur, sepse po bëhet paraqitja e njëanshme e aktiviteteve të kuvendit, si shembëll me dt.17 shkurt- Dita e shpalljes së Pavarësisë e kam udhëheqë unë mbledhjen solemne dhe zyrtarja për informim nuk e ka pa të arsyeshme asnjë fjalë rreth udhëheqjes së mbledhjes dhe asnjë foto nuk e ka postu timen si kryesues i asaj mbledhje, për fund propozoj që të bëhet një komision dhe ta harton Strategjinë në mënyrë që kjo ta merr formën ashtu si duhet.

Kryesuesi- propozon që të ngritët komisioni për hartimin e strategjisë 2023-2027 në përbërje prej 3 anëtarë nga pozita, 3 nga opozita dhe 3 nga ekzekutivi.

Në vazhdim është bërë propozimi për anëtarë të komisionit për hartimin e Strategjisë: Hajdar Sutaj, Florim Mataj dhe Floriana Hulaj nga pozita, nga opozita –Blinera Lokaj, Teuta Neziraj dhe Mon Selmonaj, nga Ekzekutivi- Dafina Cacaj, Edone Kameraj dhe Dyke Llolluni. Kryesuesi e qiti në votim përbërjen e komisionit të propozuar, anëtarët e kuvendit një zëri e miratojnë (25 për).

Kryesuesi e qiti në votim Draft Strategjinë e cila duhet ti nënshtrohet procedurës së diskutimit publik, anëtarët e Kuvendit njëzëri (25 për) miratojnë draft-Strategjinë në leximin e parë në procedurë të mëtutjeshme i nënshtrohet procedurës së diskutimit publik.

III. Rishqyrtim i vendimit të dt.28.02.2023 për bartje të hyrave vetanake nga viti paraprak 2022 në vitin aktual fiskal 2023.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë Drejtoreshës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, znj.Dafina Cacaj, e cila ka sqaruar se vendimi i kuvendit i dt.28 shkurt për

bartje të hyrave vetanake na është kthye për rishqyrtim nga MF për arsye se sipas gjendjes aktuale të mjeteve në SIMFK ka ndryshim të strukturës së shpenzimeve të cilën gjë nuk e lejon neni 9 paragrafi 6 i Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2023, prandaj kërkohet rishqyrtim i vendimit dhe orientim i mjeteve aty ku kanë qenë të planifikuara atëherë kur është bërë inkasimi i tyre në vitin 2022.
Miftar Ahmetxhekaj- pyet, ligjërisht a janë të ligjshme këto të hyra të bartura nga viti 2022 në 2023 dhe cila është vlera e kontratës (43.780 euro) dhe sa janë punët shtesë në këtë projekt(me punë shtesë është kjo shifër thotë drejtoresha, kjo është vlera e kontratës).
Orges Tafilaj- pyet, a po bartet shuma 183,174.50 euro, dhe, është dashtë me qenë diferenca këtu, për të cilën Drejtoresha sqaron se ka rrjedhë si gabim teknik mirëpo në vendim do të rregullohet kjo çështje, në pjesën e investimeve kapitale thotë ai është dashtë me qenë shifra 147,593.66 € , prandaj këto shifra duhet të rregullohen matematikisht.
Hyri Dobrunaj- kërkon sqarim te pozicioni Mirëmbajtje Verore dhe dimërore e rrugëve në Komunën e Deçanit, të cilat janë borgje të papaguara deri me tani dhe nuk jam shumë e kënaqur ka thënë ajo kur këto mjete shkojnë për larje të borgjeve.
Kryetari- përgjigjet se gjithmonë me të hyra të bartura kemi paguar borgjet, sepse janë mjete të vitit paraprak të inkasuara diku prej muajit tetor të vitit të kaluar, kur nuk mund të shpenzohen mjetet dhe deri në muajin janar për projektet e planifikuara dhe barten në vitin pasues në po të njëjtin projekt e paguhen si borgje dhe krejt kjo ndodhë për shkak të zhvillimit të procedurave, dhe jemi prej komunave që po bëjmë bartje të hyrave nga viti 2022 në vitin 2023, është e vërtetë që kemi borgje dhe po operojmë me borgje, dhe ju bëjë lutje që ta votoni këtë propozim sepse është për të mirën e qytetarëve, sepse po duhet shumë herë me shku në qeveri dhe ministri me kërku mjete buxhetore në vlera shum ma të ulta me na ndihmu në projekte të caktuara, sepse krejt kjo është në të mirë të qytetarëve.
Orges Tafilaj- ka thënë që ideja ime në diskutimin tim pak më parë ka pasë të bëjë me faktin që dokumenti duhet të rregullohet matematikisht me përmirësime.
Hyri Dobrunaj- çdo projekt ish dashtë mi pasë kodin e vet, poashtu edhe kontrata për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve duhet ta ketë kodin e vet dhe kërkoj sqarim në cilin vit është lidhë kontrata.
Kryetari- ka dhënë sqarime të shumta, ndërsa përgjigjet se është kontratë e vitit 2022 kontrata për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve.
Kryesuesi e qiti në votim propozimin e drejtorisë për Buxhet dhe Financa për bartjen e të hyrave komunale nga viti 2022 në vitin aktual fiskal 2023, anëtarët e kuvendit e miratojnë me shumicë votash , rezultati votimit ishte 17 për dhe 9 abstenim. Me këtë vendim të hyrat e bartura nga viti 2022 në vitin 2023 orientohen kështu:
*Totali për bartje është shuma prej **183.174,58€** fondi burimor**(21)**,* si në pasqyrën e paraqitur më poshtë:

- *Programi Buxhet dhe financa nën programi buxhetimi kategoria ekonomike _Mallra dhe Shërbime bartet shuma totale prej **27,552.92** euro, apo **21/631/17515/130/00000/0112..... shuma 27,552.92 euro (për hapjen e procedurave tenderuese për vlerësim të pronave komunale).***

- Programi nenprogrami Zyra e Kryetarit Kategoria ekonomike _Subvencione dhe transfere bartet shuma totale **8,028.00** euro,
  21/631/16015/200/00000/0111..... shuma 8,028.00 euro

- Programi shërbime Publike mbrojtje civile dhe emergjente Infrastruktura rrugore kategoria ekonomike Investimeve kapitale bartet shuma totale **147,593.66€** euro,
- projektin me kod 21/631/18015/300/52958/0451 Mirëmbajtja verore dhe dimerore e rrugëve ne komunën e Deçanit, kontrata ne vlerë prej **1,876,165.50Euro**, dhe obligime janë **93,813.66** Euro,

- Shuma prej **93,813.66€** Obligime ndaj Kompanisë së kontraktur "Lika Trade" për punët e kryera

- projektin me kod 21/631/18015/300/53127/0451 Ndërtimi i Qendrës rinore ne Deçan – Pune shtese, vlera e kontratës **43,780.00€** dhe obligime janë **33,780.00** €

  - shuma prej **33,780.00€** obligime ndaj kompanisë "Nb Projekt" për punët e kryera
- projektin me kod 21/631/18015/300/52958/0451 Asfaltimi dhe rregullimi i infrastrukturës te çerdhja e fëmijëve ne Deçan. vlera e kontratës **137,886.63€** dhe obligime janë **20,000.00€**
  - shuma prej **20,000.00€** obligime ndaj kompanisë "Arfa Group" për punet e kryera

IV. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2023.
Hyri Dobrunaj- thotë se është vazhdim i raporteve paraprake, vërejtjet pothuajse mbeten të njëjta për shpenzimet në kategori të njëjta, mirëpo te drekat zyrtare gjendja është pak ma mirë, ndërsa shpenzimet tjera siç është shpenzimi i buxhetit me përmbarues, derivatet dhe shpenzimi i buxhetit për kontratat për shërbime të veçanta janë shumë të larta pastaj shtron pyetjen se çka punojnë këta punëtorë me kontratë në vepër sepse kjo kategori e punëtorëve duhet të merren vetëm si ekspert në fusha të caktuara dhe pyetja rrjedh, a janë ekspert të fushës vërtetë këta njerëz, pastaj shtron pyetjen sa punëtorë janë në shërbim të kuvendit që shpenzohen gjithë këto derivate dhe pagesa për punëtorë për shërbime të veçanta.
Kryesuesi- sqaron se te zyra e kuvendit kanë qenë mjete të lira dhe drejtoresha ka ba pagesa për shërbime tjera dhe nuk janë shpenzime të kuvendit sepse si kuvend nuk kemi pasë asnjë drekë zyrtare.
Orges Tafilaj- thotë, fillimisht po të drejtohem ty drejtoreshë, meqenëse kryetari na iki, dhe konsideroj se e ki marrë parasyshë vërejtjen nga mbledhja e kaluar që kur të diskutojmë raporte të tilla të ceken si raporte të shpenzimeve ashtu si janë dhe jo si raporte analitike financiare, kështu që për këte gjë të përgëzoj, në lidhje me raportin aktual që kemi për tremujor realisht Hyria tha që është vazhdimësi e raporteve paraprake për çka edhe unë pajtohem se është vazhdimësi e raporteve tjera paraprake, i kemi pagesa për karburante për automjete pa përfshi derivatet për ngrohje dhe gjenerator 56,144.27 cent dhe realisht nëse vazhdojmë me këtë trend kemi me pasë të njëjtat shpenzime si vitin e kaluar, na kemi thane atëherë se janë shumë por meqenëse po shkojmë me këtë trend për ju prap nuk kanë me qenë shumë. Pagesa përmes vendimeve gjyqësore përmbarimore 303.062.30 cent, prap du me cekë se këto pagesa edhe pse të dhimshme më e dhimbshmja është që pjesa e interesit që na merret mund të shkon në investime kapitale, pagesa për dreka zyrtare për momentin janë 13.083.00 €, për momentin janë vetëm pagesat pa përfshi ushqimet, pijet, që ju detyrohen për institucionet tjera që janë të cekura këtu, arsyeja tjetër që në faqen e parë shohim që raporti i mallrave dhe shërbimeve me investime kapitale është tepër i madh është 65% dmth për çdo tri euro që ne i investojmë në investime kapitale 2 euro shkojnë për mallra dhe shërbime, çka shohim në këtë raport si për dreka zyrtare si për karburante shumica e pagesave që janë kry, janë kry për shpenzime që janë kry nga viti paraprak, por jo vetëm për këto për shumicën e tyre janë shpenzime për vitin paraprak dhe kur jemi këtu pyetja që realisht shtrohet edhe që ju muni mi jep edhe përgjigje edhe ministrisë por për hire të informimit kish qenë mirë edhe neve, është sa kemi borgje si komunë sepse kur sheh raporte të tilla të bën të mendosh se borgjet janë të mëdha dhe ne kemi me vazhdu me bo pagesa për borgjet paraprake. Vetëm nga zyra e kryetarit për karburante janë pagu mbi 20.000 euro për vitet paraprake pjesa tjetër, pyetje, e para Mandushe Mazrrekaj 200 euro pagujmë qera për objekte, dhe kisha dëshiru me ditë për qka paguhet, me dt.14.03 2023 nga drejtoria për buxhet dhe financa përmes përmbarimit janë pagu 4149.84 për Alfa 1 përmes përmbarimit dhe me sa pashë unë kjo pagesë është kthy dhe pyetja ime është a është akoma borgj kjo pagesë dhe çka ka ndodhë me pagesën, pagesa prej 80.000 euro për furnizim me rrymë dhe gjenerator nga drejtoria për Shërbime publike data 28 shkurt 2023 për çka edhe ku shfrytëzohen këto mjete dhe prap e kemi problemin me Kompaninë tonë publike Higjiena me 22 shkurt na u kanë marrë prej buxhetit tonë 27159 euro nga Kompania jonë publike. Krejt në fund sikur çdo herë kur shqyrtojmë raporte të tilla gjithmonë i referohemi raportit të

auditorit fatkeqësisht duke marrë parasyshë që shpenzimet pagesat që po bëhen përmes përmbaruesve, prap raporti i auditorit do të na tregon se ne kemi pasë keqplanifikim të buxhetit financiar.
Mon Selmonaj-kërkon sqarim për shpenzimin e derivateve në shumën 17267 euro, kërkon sqarim për pagesën e bërë te kategoria e sumvencioneve- Shoqata "Iniciativa e pavarur" për dy ditë nga 500 euro dhe kërkon sqarim cila është veprimtaria e kësaj shoqate, te zyra e kuvendit 2300 euro derivate brenda kësaj periudhe kohore dhe meqenëse po thuani se këto nuk janë shpenzime të kuvendit është mirë që kjo të shiqohet dhe është mirë që institucionet të harmonizohen mes veti e mos të na vjen kështu raporti.
Drejtoresha, Dafina- sqaron se tetori është muaji i fundit kur mund të bëjmë zotim të mjeteve te investimet kapitale ndërsa për mallra dhe shërbime muaji Nëntor afati i fundit për zotim dhe për këtë arsye janë mbledhë borgjet të cilat është dashtë të paguhen këtë vit për muajt e vitit të kaluar që nuk kanë lejuar procedurat që të kryhen pagesat, prandaj borgjet nga kategoria Mallra@ Shërbime janë të muajve të fundit të vitit të kaluar, vlera prej 17267 euro është specifikacion dhe nuk është një faturë, te shërbimet e veçanta ata bëjnë punë të veçanta dhe unë i paguaj deri sa ata kanë kontratë dhe nuk dëshiroj që ata me shku me përmbarim, te përmbarimet janë shujta në arsim, edhe te mallrat e shërbimet janë ma shumë, sepse shumë kontrata me herët kanë qenë kapitale e tash kanë kalu në mallra dhe shërbime- janë kontrata të mirëmbajtjes tre vjeçare por që duhet të paguhen nga mallrat dhe shërbimet, te qiraja për objekte sqaron se janë disa raste të rënda sociale që komuna jau pagunë qiranë jo përmes atij që është qiragji por qeradhënësit direkt, te Higjiena me përmbarime është faturë e muajit mars të 2022 mirëpo është prapësu dhe ka mbete deri tash , mirëpo fatura është shumë ma e vjetër, te Shoqata "Iniciativa e pavarur" është bërë pagesa gabim dhe ajo landë është liru poashtu edhe te kompania Alfa 1 e cila nuk është kompani e jona, janë bërë pagesat por mjetet i janë kthye prap komuës.
Miftar Ahmetxhekaj- ka diskutuar lidhur me këtë temë, pastaj ka dorëzuar me shkrim diskutimin e tij për këtë pikë i njëjti i përshkruhet i plotë me kërkesën e tij.

I nderuar Kryetar, të nderuar kolegë/e

Gjithnjë duke u mbështetur ne raportin të shpenzimet për periudhën Janar-Mars 2023 te paraqitur nga ana e juaj me saktësisht nga (drejtoria për buxhet e financa për muajt) Janar-Mars 2023 për vlerësimin tim, besoj edhe te kolegeve te mi, edhe pse nuk e shprehin, (arsyet i dine ata me mire) i kualifikoj si shpenzime te" këqija, te cilat po i renditi siç vijon:
Subvencionet, Qiratë për Makineri-Ndertesa ,Kontratat mbi vepër (MSHV) ,Vendimet Gjyqësore.
Dreka zyrtare
Karburant për vetura
-Subvencione, e kam potencuar edhe herëve të tjera kjo fundit siç nuk kuptohet saktë dhe drejt, Subvencioni nënkupton paratë qe i jep shteti, komuna , për një periudhë të caktuar, një institucioni, ose organizate për ti lehtësuar veprimtarin, ose mbuluar shpenzimet e ndryshme ,por gjithnjë duke i respektuar kriteret ligjore, e as se si të përdoret si asistencë sociale.
Pyetje, a mund te na informoni, a janë duke u respektuar kriteret e konkurrencës me rastin e dhënies së subvencioneve?
-Shpenzimet për qiratë e ndërtesave 400 eu
dhe makinerive.2985 eu
A mund të na informoni për cilat makineri dhe ndërtesa bëhet fjale?
-Kontratat mbi vepër, apo për shërbime te veçanta, te cilat ende vazhdojnë dhe bëhen në kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi, e kjo përben tejkalim të autorizimeve ligjore.
-Shqetësues është fakti se për shkake të keq planifikimit, keq menagjimit prape vazhdohet qe operatoret ekonomikë ti realizojnë të drejtat për pagesa me vendime gjyqësore- procedura e përmbarim.
-Shpenzime për pajisje te tjetra 4193 eu,vetëm ne Zyrën e Kryetarit,Çka nënkupton pajisje të tjera?

-Mirëmbajtje të ndërtesave 15665 eu
-Higjiena mirëmbajtje Rutinë 59117 eu
-Karburante për vetura 8598
-Dreka Zyrtare,pije-10968
-Furnizim me ushqim jo dreka,2539
- Vetëm ne zyrën e Kryetarit shpenzime për karburante, diku 20130 euro,e
Nëse e përkthejmë ne litra(llogaritja 1x1.40) dalin diku 14384 litra.
E nëse litrat i llogarisim ne km del diku 140 000 km, (nëse një veturë shpenzon edhe 10 litër për 100 km.)

I nderuar Kryetar, nëse i krahasojmë nëse i krahasojmë shpenzimet ne njërën ane, dhe i referohemi i paraqitjes se tuaj me rastin e ekspozesë se paraqitjes projekt buxhetit për vitin 2022, mes tjerash u deklaruat; **cit**/ ky është një projekt buxhet mjafte premtues, ky është projekt buxhet i cili e rrite motivin për të vepruar e jetuar në komune tonë!
Natyrshëm shtrohet pyetje kryetar i nderur, më ketë raport te shpenzimeve a e ndani ende mendimin se vërtete e keni rritur motivin e te riut dhe të rese për të jetuar në komunën tonë?
Edhe pse besoj dhe vlerësoj se përgjigjen me adekuate do ta jep auditori përgjithshëm, si i vetmi autoriteti për të bere ligjshmërinë e shpenzimeve të parasë publike.

Dafina Cacaj- përgjigjet se buxhetin për pagesa të ndryshme e marr aty ku e gjej, qiraja e makinerive është qiraja e veturave të Kryetarit dhe Nënkryetarit, te subvencionet-kryetari ka të drejtë të subvencionon deri në 1000 euro, dreka zyrtare- i kemi të gjitha klubet sportive që komuna jau ka pagu shpenzimet e drekës, ushqim dhe pije- shpija e komunitetit, mirëmbajtja rutinë-Kontrata N'Shpi, paisje tjera- blerja e disa paisjeve.
Vatan Istrefaj- shumica e shpenzimeve janë dreka dhe darka të vitit 2022, kërkon sqarim për pagesat te Banana Split, karburantet te SHP pyet çka paguhet.
Albesa Cacaj-thotë se ky raport ka të bëjë me keq menaxhim dhe keq shpenzim të parasë publike, çdo vit ka thënë ajo kryetari premton se kanë me i ndalë këto shpenzime por prap vazhdojnë me avazin e njejtë, pastaj ka thënë se ka shuma të mëdha të paguara për karburante te Zyra e Kryetarit dhe te Drejtoria për Shërbime Publike, dreka 17000 euro, përmbaruesi 150.000 euro, asnjëherë nuk mora përgjigje në pyetjen time se çka nevojiten punëtorët për shërbime të veçanta, gjatë këtij raporti e vërejta që dy ish asamblist që këtu gjatë mandatit të tyre nuk e kanë qelë kurr gojën e tash kishin kontratë për shërbime të veçanta dhe të njëjtit pu pagujshin për shërbime të veçanta si ekspert, dhe natyrshëm shtroj pyetjen çfar ekspertë janë ata.
Leotrim Hadergjonaj-pyet, lidhur me Kompaninë Higjiena, a ka mundësi një herë në tre muaj me ja pagu një faturë edhe mos me pasë nevojë me shku me përmbarues ata.
Florim Mataj- thotë se u diskutu shum për këtë raport, u debatua pothuajse për çdo shpenzim të tij, po vërehet se ka ramje të lehtë te shpenzimi për dreka dhe uroj që të vazhdon ky avaz, edhe te shpenzimet me përmbarues ka ramje dhe kërkoj nga ekzekutivi që të jenë të kujdesshëm me kryerjen e pagesave dhe mos të ketë nevojë me shku deri te përmbaruesi, te derivatet në Zyre të Kryetarit është mirë mi pasë ni sqarim edhe na për këto shpenzime.
Kryesuesi-thotë se e ceka ma herët se drejtoresha i merr mjetet buxhetore për pagesa aty ku i gjenë të lira dhe kjo tregon se nuk janë ato që paguhen vetëm shpenzimet e nji drejtorie përkatëse ose në këtë rast të zyrës së Kryetarit.
Blinera Lokaj- kërkon sqarim për pagesën prej 25.000 euro për LC e SHPK, kush është ky biznes dhe me çka merret.
Drejtoresha Dafina- përgjigjet se e kemi një program për energji efiçiente.
Orges Tafilaj- pagesat përmes përmbaruesit- gjysma e tyre janë investime kapitale, kërkon sqarim për "Kthimi i pagesës" për të cilën drejtoresha thot se janë kthye mjetet, te drejtoria e inspekcionit duhet të ndërrohet data.
Kryesuesi- meqenëse u konsumu debati rreth këtij raporti, debatin rreth tij e mbyllim.

V.Të ndryshme.
1.Caktimi i lokacionit për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore.
Kryetari- ka sqaruar se është projekt sipas Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Deçanit-Kosovë dhe Qendra "Integrim e Zhvillim Demokratik"- Shqipëri; Programi IPA 2 Shqipëri – Kosovë, projket i cili parasheh ngritjen e një fidanishte, është një mundësi e mirë nëse arrijmë ta fitojmë si projekt, por nga ne kërkohet ta caktojmë lokacionin ku do të ngritët kjo fidanishte.
Hyri Dobrunaj- thotë duhet mi lexu materialin i cili nuk ka ardhë me kohë për të dijtë saktë çka po kërkohet dhe ku është ky lokacion.
Florim Mataj- thotë se Kryetari i dha sqarimet dhe sipas sqarimeve të Kryetarit ta qesim në votim.
Orges Tafilaj- si iniciativë e përkrahim si grup, por kërkoj sqarim saktësisht ku parashihet ndërtimi , saktë ku është destinacioni.
Kryetari- thotë se është projekt i përbashkët nga bashkëpunimet ndërkufitare me buxhet ndërkombëtarë, është praktikë e mirë sepse njerëzit mësohen si mi realizu këtë projekt, sqaron edhe për vendin ku caktohet lokacioni, ndërsa nëse e shtrojmë pyetjen- a kemi nevojë për këtë projekt dhe të tjera të kësaj natyre, po , kemi nevojë si komunë.
Miftar Ahmetxhekaj- e para, kërkesat cila do çoftë nuk ki obligim mi bo nëse nuk ka përfitim, ndërsa pyetja ime lidhur me këtë temë është, a kini ba naj analizë cili është përfitimi i komunës së Deçanit me këtë projekt.
Kryetari ka sqaruar në pyetjet e ngritura.
Kryesuesi e qiti në votim, anëtarët e kuvendit me 23 vota pro, 2 abstenim e miratojnë.
2.Shquqizimi i Vendimit të Kuvendit i dt.25.03.2013, me të cilin është Aprovuar lista rezervë për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Deçanit.
Kryesuesi e ka prezentu këtë temë pastaj ka shtuar se është shum e nevojshme shfuqizimi i atij vendimi me atë listë të emrave dhe krijimi i një liste të re sipas kërkesave dhe nevojave aktuale të qytetarëve në teren, meqenëse nuk kishte diskutime, kryesuesi e qiti në votim, antarët e kuvendit njëzëri marrin vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit i dt.25.03.2013, me të cilin është Aprovuar lista rezervë për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Deçanit.
Miftar Ahmetxhekaj- thotë se në të ndryshme kamë dy pyetje, Meqenëse është kah bëhet zgjerimi i rrugës Qendra me katër korsi, Pyetja e parë rreth Urës së Demës, a ju ka bërë testi beton armesë meqenëse është e vjetër 60-70 vjet, dhe po në këtë rrugë ndërtimi i Stacionit të autobusëve në fshatin Isniq në drejtimin Pejë –Deçan- sqarim, dhe rreth rrotullimi te rruga Beqir Loshi-sqarim.
Kryetari- sipas ekpertëve që e kanë bërë ekspertizën dhe kanë konstatuar se Ura e Demës është në gjendje të rregullt dhe i plotëson kushtet, Stacioni autobusëve në drejtim të Pejës në fshatin Isniq kemi pasë hapsirë dhe e kemi rregullu stacionin kurse në krahun në drejtim të Deçanit në Isniq nuk po kemi hapsirë të mjaftueshme, rreth rrotullimi në Isniq nuk kemi pasë mundësi tjetër dhe kjo ka qenë mundësia për mi shti në funksion këtë rrugë, nuk kemi pasë mundësi tjetër.
Faton Selmanaj-pyetje për rrugë, disa qytetar janë anku për vend ndaljen në Isniq-thanë se kan pengu pronën private, dhe pyetje është- kurë do të ekzekutohen bursat e studentëve.
Kryetari ka sqaruar për stacionin e autobusëve në Isniq, për bisedimet e zhvilluara dhe mundësitë me ba zgjidhje.
Drejtoresha Dafina- sqaron se bursat do të ekzekutohen në fillim të muajit maj.
Leotrim Hadergjonaj- sqaron për projektin e zgjerimit të Urës së Demës se është projekt me tri faza edhe testimi i betonit është krye dhe krejt këto janë publike.
Albesa Cacaj- fillimisht thotë se e përgëzoj praninë e Kryetarit në fund të mbledhjes kur debatohet pika Të ndryshme, në mbledhjen e kaluar i kam shtru dy pyetje për të cilat është dashtë kryetari me dhanë përgjigje në këtë mbledhje, pyetjet kanë qenë : 1. Pse kanë ngece punimet në ndërtimin e fushës së sporteve në fshatin Irzniq- pse nuk kanë vazhdu punimet (kërkesë e qytetarëve të fshatit), dhe 2.Ndërtimi i Çerdhes së fëmijëve në shkollën Fillore në Deçan- pse nuk kanë filluar ende punimet e çerdhes aty, dhe pyetje tjetër që do të shtroj sot është lidhur me temën e qenëve endacak

për të cilën është formu komisioni dhe ai komision ka punuar e ka kry punën e vet dhe i ka dhanë disa rekomandime, pyetja ime është- cilat masa i ka marrë kryetari për implementimin e Rekomandimeve të Komisionit.
Kryetari- përgjigjet, për fushën e sportit në fshatin Irzniq, për tu realizu ai projekt duhet mu shty rruga dhe aty është pengesa, Qerdhja në vitin 2022 e kemi pasë në kod buxhetor, në 2023 nuk është si kod sepse Ministria e ka qitë si projekt në 2024, Qent endacak janë ba dy aktivitete AVUK-Komuna, ne si komunë jemi angazhu në këtë temë por Trajtimi i qeneve endacak është përgjegjësi e AVUK.
Mon Selmonaj- ngritë çështjen e zgjedhjes së Këshillave Lokale të Fshatrave- pse po zhegitët ky proces.
Kryesuesi- në fund ka paraqitë edhe një Pikë-dorëheqjen e Yllarta Thaqit, Floriana Hulaj dhe Elmedina Sadikaj nga Komisioni për emërim të rrugëve.
Yllarta Thaqi- kryesuese e komisionit për emërim të rrugëve thotë se si komision kemi punuar shumë, mirëpo unë e paraqes dorëheqjen time nga ky komision për arsye të mos funksionimit të zingjirit për të realizuar kërkesat e qytetarëve, punë të cilat kanë mbete pezull.
Miratohet dorëheqja e Yllarta Thaqit kryesuese dhe si anëtare e komisionit për emërim të rrugëve dhe anëtareve të Komisionit Floriana Hulaj dhe Elmedina Sadikaj, miratimi bëhet me 18 vota për, 3 kundër dhe 3 abstenim.
Mon Selmonaj- thotë se është dashtë Yllarta mu konsultu me komisionin paraprakisht pa e sjellë dorëheqjen, dhe, të gjithë si komision, mu dakordu dhe mi marrë një vendim të përbashkët.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ